


	Shenime	31/12/2016	31/12/2015	
AKTIVET				
I	Aktivt afatshkurtra			
1	Mjete monetare dhe ekuivalente	5	382,339	-
2	Të drejta të arkëtueshme			
a	Kërkesa të arkëtueshme	6	1,429,286	-
b	Të tjera të arkëtueshme		-	-
c	Instrumente të tjera financiare		-	-
			1,429,286	0
3	Inventari			
a	Lëndë të para dhe materiale të		-	-
b	Prodhim në proces dhe gjysëm produkte		-	-
c	Produkte të gatshme		-	-
d	Mallra për shitje		-	-
e	Parapagesa për inventarë		-	-
	Totali i aktiveve afatshkurtra		1,811,625	-
II	Aktivt afatgjata			
1	Aktive afatgjata financiare			
a	Depozita afatgjata, huadhënie dhe të tjera	7	4,151,210	-
b	Dëftesa të arkëtueshme dhe klientë		-	-
2	Aktivt afatgjata materiale			
a	Toka dhe Ndërtesa		-	-
b	Makineri dhe Pajisje		-	-
c	Të tjera në shfrytëzim	8	732,804	-
3	Aktivt afatgjata jomateriale			
a	Patenta, licenca, të drejta të tjera të		-	-
	Totali i aktiveve afatgjata		4,884,014	-
	TOTALI I AKTIVEVE		6,695,639	0

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga LLF LEGAL & TAX shpk ne date 27/02/2017, dhe jane firmosur nga:

LLF TAX & LEGAL sh.p.k



LLF LEGAL TAX SHPK

**Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
(Shumat ne LEK)**

(Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve liston zerat e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyres)

	12/31/2016	12/31/2015
I TE ARDHURAT	6,936,611	0
Sherbimet e kryera	6,936,611	
Furnizimet e mallrave	-	-
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	-	-
II SHPENZIMET	820,737	0
1 Kostoja e mallrave te shitura (a-b)	-	-
a Blerje te mallrave gjate vitit	-	-
b Gjendje e inventarit ne fund te periudhes	-	-
2 Shpenzimet e tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit	417,354	0
a Energji, uje, telefon dhe internet	-	-
b Shpenzime mirembajtje zyre	170,000.00	-
c Qira zyre	80,000	-
d Komisione bankare	35,959	-
f Taksa e tarifa vendore	7,500	-
g Sherbime konsulence	15,000	-
h Sherbime te ndryshme administrative	69,429	-
i Shpenzime kancelarie	29,458	-
j Penalitete	10,008.00	-
3 Kosto personeli	341,712	-
a Paga bruto	336,000	-
b Sigurime shoqerore dhe shendetesore	5,712	-
4 Shpenzime amortizimi	61,671.00	-
Fitim/humbja nga veprimtaria e shfrytëzimit	6,115,874	0
III Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	(51,215)	0
1 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		
2 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	-51,215	-
Fitim/humbja para tatimit	6,064,659	0
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	303,733.00	
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	5,760,926	0

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga LLF LEGAL & TAX shpk ne date 27/02/2017, dhe jane firmosur nga:

LLFTAX & LEGAL sh.p.k

LLF LEGAL & TAX

NIPT: L61314012G

Tirana - Albania

LLF LEGAL TAX SHPK
 Pasqyra e Pozicionit Financiar- PASIVI ne 31 Dhjetor 2016
 (Shumat ne LEK)

DETYRIMET DHE KAPITALET E VETA	Shenime	12/31/2016	12/31/2015
I Detyrime afatshkurtra			
1 Tituj të huamarrjes			
2 Detyrime tregtare			
a Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		-	-
b Shpenzime te perlogaritura		-	-
c Të pagueshme ndaj punonjësve		-	-
d Detyrime tatimore	9	513,112	-
e Detyrime per huate e dhena	10	411,600	-
		924,712	0
II Detyrimet Afatgjata			
1 Tituj të huamarrjes		-	-
2 Te tjera		-	-
		0	0
III Kapitalet e Veta			
a Kapitali i pronarit		10,000	-
b Fitimi / Humbja e mbartur		-	-
c Fitimi / Humbja e vitit financiar		5,760,926	-
d Tërheqjet e pronarit		-	-
		5,770,926	0
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALEVE TE VETA		6,695,639	0

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga LLF LEGAL & TAX shpk ne date 27/02/2017, dhe jane firmosur nga:

LLF TAX & LEGAL sh.p.k



Dukeq

1. Informacion i pergjithshem

LLF LEGAL & TAX sh.p.k, (referuar ne vazhdim si "Shoqeria") eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar ne daten 14/01/2016. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne adresen "Rruga Gjin Bue Shpata, Godina e Aviacionit te vjeter, Hyrja 7, Kati 1, Ap. 34, Tirane". Aktiviteti kryesor i Shoqerise eshte ofrimi i sherbimeve ligjore duke perfshire, perfaqesim ne gjykate, konsulence juridike, perfaqesim prane institucioneve shtetore, konsulence tatimore, sherbime konsulence dhe mbeshtetese per shoqerite dhe individet, perfaqesues tatimor, si dhe aktivitete te tjera tregtare ne perputhje me kuadrin ligjor perkates.

Kompania zoterohet 100% nga individi z. Erion Lena (Ortaku i Vetem).

Kompania e filloi aktivitetin me nje kapital te regjistruar ne vleren 10,000 LEK, pjesetuar ne 1 kuote, me vlere nominale 1,000 LEK.

Ne daten 31 Dhjetor 2016, Shoqeria ka ne listepagese 1 punonjes, drejtuesin ligjor.

Shoqeria ka filluar aktivitetin ne periudhen raportuese dhe gjate vitit te pare ka zhvilluar nje aktivitet te qendrushem, por ne limitet e kategorise se tatimpaguesve subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin dhe per taksat vendore.

2. Deklarata e Perputhshmerise

2.1 Kuadri ligjor kontabel i zbatuar jane Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Shqiperise (SKK 15).

2.2 Baza e pregatitjes se Pasqyrave Financiare eshte kontabiliteti i te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

2.3 NJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE: ka regjistruar vetem aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike te saj.

2.4 VIJUESHMERIA: njesia ekonomike raportuese nuk planifikon dhe as nuk i duhet te nderprese veprimtarine operacionale.

2.5 Principet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per pregatitjen e Pasqyrave Financiare:

- a) KUPTUESHMERIA. Informacioni ne Pasqyrat Financiar eshte paraqitur ne menyre te qarte dhe i plote, eshte i kuptueshem nga perdoruesit qe kane njohuri te pergjithshme dhe te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
- b) RENDESIA. Pasqyrat Financiare jane pregatitur duke paraqitur kategorite dhe zerat kryesore kontabel, qe jane të rëndësishem për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe që mund të ndikojnë në vendimmarrjen e tyre.
- c) BESUESHMERIA. Ne pregatitjen e Pasqyrave Financiare eshte siguruar qe informacioni i paraqitur te jete i paanshem, pa gabime apo pasaktesi materiale, te jape një prezantim besnik te asaj që ky informacion përpiqet në mënyrë të arsyeshme të prezantojë. Transaksionet jane kontabilizuar dhe paraqitur ne perputhje me substancen dhe realitetin ekonomik te tyre dhe jo vetem duke u nisur nga forma ligjore e tyre.
- d) KRAHASUESHMERIA. Per shoqerine eshte viti i pare i aktivitetit, keshtuqë informacioni nuk mund te jete i krahasueshem me ate te nje periudhe tjeter.

- e) **KOMPENSIMI:** Aktivet dhe pasiven nuk jane kompensuar me njera tjetren, nderkohe qe te ardhurat dhe shpenzimet jane kompensuar vetem kur lejohet nga Standartet Kombetare te Kontabilitetit

2.6 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat Financiare jane paraqitur ne monedhen Shqiptare (LEK) qe eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise

2.7 Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SSK kerkon gjykime, vleresime dhe supozime nga ana e Drejtimet te Shoqerise te cilat mund te ndikojne aplikimin e politikave dhe vlerave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

Vleresimet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet ne vleresimet kontabel jane njohur per periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar dhe per periudhat e ardhme te ndikuara.

3. Politikat kryesore kontabel

Nje permbledhje e politikave kryesore kontabel me te rendesishme te aplikueshme pasqyrohet me poshte:

3.1. Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe vleresimi

Elementet e aktiveve afatgjata materiale vleresohen me kosto historike pakesuar per amortizimin e akumuluar apo zhvleresimin. Kosto perfshin shpenzimet qe i atribuohen drejtperdrejt pervetesimit te aktivitetit.

(ii) Kostot e mepasshme

Kosto e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale i shtohet vleres se mbartur te aktivitetit vetem nqs parashikohet qe kjo pjese te sjelle perfitime ekonomike te ardhme per shoqerine dhe kosto mund te matet ne menyre te besueshme. Vlera e mbetur e pjeseve te zevendesuara crregjistrohet. Kostot qe rrjedhin nga perdorimi normal i aktiveve afatgjata materiale jane njohur ne fimime apo humbje kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi pasqyrohet ne fitime apo humbje bazuar ne metodën e vleres se mbetur, e cila perafrohet mesatarisht jete ekonomike. Normat vjetore te aplikuar te zhvleresimit jane si me poshte:

Pajisje zyre	20%
Pajisje elektronike	25%

3.2. Llogarite e arketueshme dhe te pagueshme

Llogarite e arketueshme jane njohur fillimisht me vlere te drejte dhe vleresuar me pas me kosto te amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvleresimi. Nje provizion per zhvleresimine llogarive te arketueshme llogaritet nese ka te dhena objektive qe Shoqeria nuk do jete ne gjendje te arketoje te gjitha shumatat qe i detyrohen ne baze te termave origjinale te arketimeve. Veshtiresite financiare te debitorit, probabiliteti qe debitori shkon drejt falimentimit apo riorganizimit financiar, si edhe mospagesat konsiderohen si tregues qe logaria e arketueshme eshte zhvleresuar.

Shuma e provizionit eshte diferenca midis vleres se mbartur dhe vleres se rikuperueshme, duke perbere vleren aktuale te fluseve te pritshme monetare, te skontuara me normen e interest te tregut per kreditore te ngjashem.

3.3. Mjete monetare dhe ekuivalente

Mjete monetare dhe ekuivalente perfshin para ne arke, llogari korrente me bankat, investime te tjera afatshkurtra likuide me maturitet original tre muaj ose me pak, te cilat jane subjekt i ndryshimeve jo te rendesishme ne vleren e tyre te drejte dhe perdoren nga shoqeria per te permbushur detyrimet afatshkurtra.

3.4. Kapitali

Kapitali eshte njohur ne pasqyrat financiare me vleren nominale.

3.5. Njohja e te ardhures

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitime ekonomike do i vijne shoqerise dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri.

3.6. Perfitimet e punonjesve dhe planet e pensionit

Shoqeria kontribuon per planet e pensionit te te punesuarve ne perputhje me legjislacionin per sigurimet shoqerore. Kontributet, bazuar ne paga, behen ne organizmat pergjegjes per pagesen e pensioneve. Nuk ka detyrime te tjera ne lidhje me keto plane.

3.7. Shpenzimet

Shpenzimet njihen ne fitime ose humbje ne periudhen ne te cilen ato ndodhin.

3.8. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare lidhen me fitimin apo humbjen e njohur nga kursi i kembimit per kembimet ne monedhe te huaj, si dhe me shpenzimet apo te ardhurat nga interesi i huave.

3.9. Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen matese me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare te njohura ne monedhe te huaj ne daten e raportimit jane rikonvertuar ne monedhen funksionale me normen e kembimit te kesaj date.

Fitimi apo humbja valutore nga elementet monetare eshte diferenca ndermjet kosos se amortizuar ne monedhen funksionale (LEK) ne fillim te periudhes, e rregulluar me normen efektive te interesit dhe pagesave gjate periudhes dhe kosto e amortizuar ne monedhe te huaj e konvertuar me normen e kembimit ne fund te periudhes.

Aktivitet dhe detyrimet jo - monetare te njohura ne monedhe te huaj e qe jane vleresuar me vleres te drejte, jane konvertuar ne monedhen funksionale me normen e kembimit ne daten e percaktimit te vleres se drejte. Diferencat nga kursi kembimit lindur nga rikonvertimet jane njohur si fitime apo humbje pervec diferencave nga rikonvertimi i instrumentave te kapitalit te vlefshme per shitje (ne qofte se ka), te cilat jane njohur ne te ardhura te tjera te hollesishme.

3.10. Tatim fitimi i periudhes

Shpenzimi i tatimit mbi te ardhurat perbehet nga tatim fitimi korrent dhe tatim fitimi i shtyre. Shpenzimi i tatimit njihet ne fitim ose humbje deri ne masen e njohur direkt ne kapital ose te ardhura te tjera permbledhese.

Tatimi korrent eshte tatim i llogaritur, i pagueshem mbi te ardhurat e tatueshme te periudhes ushtrimore duke perdorur normat tatimore te vlefshme ne daten e raportimit dhe cdo rregullim qe i behen tatimit te pagueshem lidhur me vitet e meparshme.

Tatim fitimi i shtyre eshte njohur per diferencat e perkohshme ndermjet vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per efekt te raportimit financiar dhe vlerave te tyre per efekte tatimore.

Tatim fitimi i shtyre eshte njohur per humbje taksash te paperdorura, kreditime taksash dhe diferenca te zbritshme te perkohshme, deri ne masen qe, fitime te ardhshme te tatueshme do te mund te jene disponueshme kundrejt te cilave ato mund te sistemohen. Aktivitet e tatim fitim te shtyre rishihet ne cdo date raportimi dhe reduktohen deri ne masen qe nuk eshte me e mundur qe perfitimi perkates fiskal te mund te realizohet

Ne statusin aktual te regjistrimit (tatimpagues subjekt i tatimit te thjeshtuar te fitimit mbi biznesin e vogel), Shoqeria nuk perfiton nga mbartja e humbjeve per qellime tatimore, dhe rrjedhimisht nuk mundet te njohet aktive tatimore te shtyra ne lidhje me humbjet tatimore te paperdorura.

4. Percaktimi i vleres se drejte

Vlera e drejte per mjetet monetare dhe te ngjashme, eshte afersisht e barabarte me vleren e tyre te mbartur per shkak te maturitetit te tyre afatshkurter.

5. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Ky ze perbehet nga mjetet monetare gjendje ne llogarine rrjedhese prane Bankes Tirana ne daten 31.12.2016. Shoqeria ka llogari rrjedhese ne monedhen leke dhe euro. Gjendja e parave ne monedhen euro eshte paraqitur ne pasqyrat financiare ne monedhen leke e konvertuar me kursin zyrtar te publikuar nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se vitit financiar.

6. Kerkesa te arketueshme

Ky ze paraqet kerkesen qe ka shoqeria ndaj klienteve te saj, per vlera te papaguara ne mbyllje te vitit ushtrimor, te lidhura me ofrimin e sherbimeve ligjore dhe te kontabilitetit. Keto te drejta jane arketuar ne fillim te vitit 2017.

7. Depozita afatgjate dhe huadhenie afatgjate

Ne fund te vitit 2016 ky ze paraqet huane qe shoqeria i ka dhene Ortakut te Vetem, z. Erion Lena, sipas kontrates te dates 07.12.2016. Huaja eshte dhene pjeserisht ne monedhen euro dhe pjeserisht ne monedhen leke, perkatesisht ne vlerat 27,000 euro dhe 500,000 leke.

8. Aktivet afatgjata materiale

Zeri i aktiveve afatgjata materiale ne daten 31 dhjetor 2016, perbehen nga si me poshte:

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
Kosto historike			
Gjendje me 01.01.2016	-	-	-
Shtimet	493,500	300,975	794,475
Totali me 31.12.2016	493,500	300,975	794,475
Amortizimi			
Gjendje me 01.01.2016	-	-	-
Amortizimi i vitit	-41,125	-20,546	-61,671
Totali me 31.12.2016	-41,125	-20,546	-61,671
Vlera neto			
Me 01.01.2016	-	-	-
At 31 December 2015	452,375	280,429	732,804

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore konsistojne ne kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore dhe shendetesore muaji dhjetor 2016, tatimi e mbajtur ne burim per muajin dhjetor 2016, TVSH e pagueshme muaji dhjetor 2016 dhe detyrimi per tatimin e thjeshtuar mbi fitimin per vitin 2016. Te gjitha keto detyrime jane paguar ne fillim te vitit 2017, brenda afateve ligjore te detyrueshme per pagese.

10. Detyrime per huate e dhena

Ky ze perbehet nga vlera e patransferuar ne mbyllje te vitit 2016 ndaj Ortakut te Vetem, per huane e dhene, sipas kontrates se huadhenies date 07.12.2016.

12. Shpenzimi per tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel

Normat e tatimit te thjeshtuar mbi biznesin e vogel per vitin 2016 kane qene si me poshte:

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i aplikueshem per tatimpaguesit e biznesit te vogel me nje qarkullim vjetor midis 0-5 Milion LEK, eshte ne shumen fikse 0 LEK.
- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per te njejten kategori tatimpaguesish, qe gjate vitit 2016 kane realizuar nje qarkullim midis 5-8 Milion LEK, eshte ne normen 5% te fitimit te tatueshem.

Shoqeria gjate vitit 2016 ka realizuar te ardhura nga aktiviteti ne vleren 6,936,611 leke, per rrjedhoje bie ne kategorine e dyte si me lart, duke u tatuar me norms 5%.

Shoqeria nuk ka njohur aktiv tatimor te shtyre ne lidhje me humbjet tatimore te paperdorura, sepse nuk mund te perfitoje ne rradhe te pare nga mbartja e humbjeve tatimore qe lejohet vetem per tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin. Gjithashtu, edhe ne rastin nese Shoqeria do ishte regjistruar si subjekt i tatimit mbi fitimin, nuk do te njihete nje aktiv tatimor te shtyre ne vitin 2016 duke qene se nuk eshte e sigurte qe ajo do te kishte fitime tatimore te mjaftueshme ne periudhen pasuese kundrejt te cilit do te perdorej humbja tatimore e mbartur.

13. Palet e lidhura

Nje pale e lidhur eshte nje person apo kompani qe eshte e lidhur me Shoqerine qe pergatit dhe raporton pasqyrat financiare, qe i) kontrollon e vetme apo bashkerisht Shoqerine raportuese ii) ka dhe ushtron influence te ndjeshme mbi Shoqerine raportuese, iii) eshte anetar apo personel kryesor i drejtimit te Shoqerise raportuese apo i Kompanise meme te Shoqerise raportuese.

Detyrime ndaj:

31 dhjetor 2016

Ortaku i Vetem (z. E. Lena)

(pjesa e huase e patransferuar ne llogari te huamarresit)

411,600

Detyrime nga:

31 dhjetor 2016

Ortaku i Vetem (z. E. Lena)

(huadhenia afatgjate)

4,151,210

14. Ngjarjet pas dates se bilancit

Drejtimi i Shoqerise nuk eshte ne dijeni te ndonje ngjarje qe ka ndodhur pas dates se raportimit, i cili jep te dhena per kushte qe kane ekzistuar gjate periudhes raportuese per te cilat do te duhej te beheshin rregullime apo te jepeshin informacione te tjera shpjeguese ne pasqyrat financiare.

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga LLF LEGAL & TAX shpk ne date 27/02/2017, dhe jane firmosur nga:

LLF LEGAL & TAX sh.p.k

